Ndërkaq, ajo që për sektorin joqeveritar është përparësi dhe që i bën të jenë më efikas dhe më të mirë, në një pjesë të punëve, është shpejtësia dhe efikasiteti i tyre me të cilën mund të menaxhojnë projekte hulumtimi, dhe mua më vjen keq që, në prezantimin tim, duhet t'i kushtoj më shumë vëmendje menaxhimit të projekteve se sa pjesës supstantive, metodologjisë dhe procesit hulumtues. Ndërkaq, menaxhimi u bë pjesë e procesit shkencor hulumtues i cili, të paktën, është njësoj i lodhshëm. Përparësia më e madhe këtu në tink- tanket është se nuk ka kurrfarë pengesash administrative dhe procedura burokratike gjatë menaxhimit të projekteve. Në sferën e shkencave shoqërore kjo është mjaft qenësore edhe për tu dhënë forcë ekspertëve, edhe që të mund bëni pagesën në kohë edhe që të mundeni t'i zbatoni në mënyrë adekuate instrumentet e vetë hulumtimit, sepse asnjë hulumtim i mendimit publik, asnjë grup fokusimi, asnjë intervistë, nuk do të mund ta realizoni pa përcaktim adekuat të mjeteve. Prandaj tink-tenket këtu gjithherë do të kenë përparësi para universiteteve. Ata kanë edhe mundësi më të madhe përsorsing (burime të jashtme). Nëse i shihni rregullat për draftimin e ekspertëve në mësim, siç janë kriteret, mund të supozoj se çfarë do të kërkojnë universitetet nëse në projekt nisni të angazhonи njeri nga jashtë. Rregullat e reja janë absolutisht rigoroze, kërkohen përvoja shumë të mëdha jetësore, njoburi, kualifikime akademike dhe, praktikisht, është e pamundur të merrni mysafir-ligjërues nga jashtë dhe ta futni në program. Nga ana tjeter, ajo që mund të jetë përparësi dhe mangësi e vet tink-tenkeve është laramania tematike dhe mendoj se te universitetet ekziston mentalitet tejet dominues, që ndoshta është mirë, ndoshta është keq, që kryesisht u përbahen atyre temave që i kanë të njobura. Mangësia më e madhe dhe gjëja më jo stimuluese, që e kam hasur deri më tash unë dhe shumica e kolegëve të mijë, është burokratizimi i tmerrshëm dhe kapaciteti administrativ që rek-

Mendoj se Universitetet perceptohen nga publiku i përgjithshëm si organizata pasive, të myllura, si bastione, dhe njerëzit i perceptojnë si organizata të cilat kanë shumë pak hulume dhe prodhim

Përparësia më e madhe këtu në tink- tanket është se nuk ka kurrfarë pengesash administrative dhe procedura burokratike gjatë menaxhimit të projekteve

torati tani, në të vërtetë, edhe nuk i ka. Rregullat dhe procedurat e reja janë të gjata dhe të ndërlikuara. Fakultetet nuk janë fleksibil lidhur me disa çesh-tje, veçanërisht në këtë pjesë burokratike, por, ende, një pjesë e kuadrit të fa-kulteteve është skeptik që të bashkëpunojë me tink-tenket, posaçërisht në sferën e shkencave shoqërore. Janë skeptik dhe dukshëm të rezervuar, përkatësisht, më shpesh kërkojnë partner të vetin në universitete të tjera dhe mendoj se te një pjesë bukur e mirë, por jo edhe te të gjithë, është i pranishëm mendimi se me tink-tenket nuk duhet të punohet sepse nuk janë partner i barabartë i universiteteve, që unë mendoj se është tezë qesharake. Mendoj se simbioza e sektorit joqeveritar dhe akademia do të zgjidhë shumë probleme. Është normale që të ketë një rezervim. Por, mendoj se ai qëndrim i përgjithshëm ndaj tink-tenkeve dhe sektorit joqeveritar duhet ndryshuar. Ajo për të cilën të gjithë reagojnë në këtë menaxhim projekti, që do ta ndryshonte në mënyrë supstantive autputin e shkencave shoqërore, do të mundësonë që procesi të jetë më i lehtë dhe të mos jetë aq i ngarkuar me burokraci, është trajtimi i mjeteve për projekte hulumtimi nga jashtë, trajtimi i mjeteve si dhe i të gjitha mjeteve të tjera buxhetore të cilat duhet patjetër të kalojnë nëpër llogarinë e Ministrisë së financave, praktikisht nëpër llogarinë e Bankës popullore, dhe trajtohen si mjete publike të cilat ua marrin në fund të vitit, pastaj ua kthejnë e kështu me radhë. Mendoj se përvëç DHP-së dhe Ministrisë së financave, asnë profesor,asnë asistent,asnë docent asnë magjistruës etj. nuk e ka të qartë pse bëhet kjo dhe mendoj se kjo është çështje e pozicionit ideologjik. Tanimë jemi duke hyrë pak edhe në çështjen e pozitioneve politike pse ato të holla i trajtonë si të holla të shtetit, ndërsa ato nuk janë të tilla. Ato para janë sjellë me projekte nga jashtë, kurse mundësia për kontroll nuk humbet po se qe i leni këto mjete të jenë jo fleksibile në shpenzimin dhe realizimin e tyre. Pse është patjetër t'i futni në buxhet e pastaj t'i lejoni, mandej të kalkuloni sa duhet shpenzuar, dhe ky është një qëndrim pak arrogant nga ana e shtetit dhe këtu më hyjmë në sferën e gjithëpërfshirjes së shtetit në segmente të caktuara. Megjithatë, kjo është kështu dhe sipas asaj që e shoh në këta takime, të njerëzve që punojnë në projekte ndërkombëtare, kjo nuk do të ndryshojë.

Pika e dytë e ndjeshme ka të bëjë me vetë menaxherin e projektit. Ai është trajtimi çuditshëm të cilin e marrim ngandonjëherë prej DHP-së veçanërisht kur është fjalë për shpenzimet të cilat tatimohen. Shpenzimet duhet të tatimoren, por jo edhe të ardhurat. Të paguhet tatim personal për vetë honorarët është punë krejtësisht normale, askush për këtë nuk do të kundërshtonte , megjithatë, të paguani 10% për bileta aeroplani që i keni blerë, kjo është diçka që të gjithë profesorët e ngriten siç çështje, por nga DHP-ja nuk morëm kurrrfarë përgjigje. Më herët, të gjitha pagesat bëheshin thjesht, me kërkessë , kurse tash situata është më e ndërlikuar dhe nënkupton 7 hapa për

**GJENDJA E HULUMTIMEVE NË SHKENCAT
SHOQËRORE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË**

kryerjen e një pagese, që për mua absolutisht është jo stimuluese, ose për çdo hulumtues të ri i cili do të hynte në procesin, po qe se nuk fiton mbështetje të njëmendët administrative. Nëse vazhdon situata e këtillë nuk mendoj se ndonjëri do të ketë stimulim të veçantë, përpos, nëse nuk ristrukturohet logjika, sipas së cilës funksionojnë universitetet, punët të zhvillohen pak më me orientim projektesh dhe më menaxhuese. Situata e këtillë, sipas meje, do të shpie kah kërkimi i mekanizmave, metodave dhe modalitetave alternative që të realizohet ajo që është fokus i hulumtimeve shkencore shoqërore të vetë kuadrit akademik. Kjo nuk është praktikë e panjohur në Perëndim. Atje gati të gjithë profesorët janë anëtarë të tink-tenkeve, OJQ-ve dhe qendrave hulumtuese me renome.

**NEDA KORUNOVSKA
(HULUMTUESE NË TINK-TANKUM REAKTOR)**

Është detyrë e vështirë të flitet për këtë temë nga aspekti i problemit që vlen për të gjitha aspektet e hulumtimeve në fushën e shkencave shoqërore dhe humanitare, e kjo është mungesa e të dhënavë. Nuk ka një analizë sistematike të hulumtimeve, cilat tema kanë qenë objekt interesimi, si janë vendosur ata dhe cilat janë rezultatet gjatë dy dekadave të kaluara. Ndoshta janë më relevante të tre hulumtimet e bëra nga UNESKO në të cilat është përfshirë edhe Maqedonia dhe ai i fundit i vitit 2010 i cili ka një titull të mirë “Knowledge device”. E para, me çka nuk do të pajtohem, është ajo se a kemi ne kapacitet dhe, vallë, a ka kapacitet skena ose rrjeti ynë hulumtues në Maqedoni që i përfshin jo vetëm publikun akademik, institucionet shtetërore dhe sektorin joqeveritar. Pra, kapacitet nuk ka, jo vetëm te ne por edhe në të gjitha vendet tjera, përvèç Amerikës Veriore dhe Evropës Perëndimore , bile edhe Anglinë do ta trajtoj si pjesë e kësaj, sepse njëri prej problemeve kyç është favorizimi i gjuhës angleze dhe publikimi i gjuhës angleze në ato indekse globale, 85-90 për qind i të gjitha hulumtimeve janë në gjuhën angleze. Fakt kyç është ajo që me të vërtetë më pak hulumtime, më pak të dhëna ekzistojnë atje ku ato janë më të nevojshme- në vendet në zhvillim, në vendet në tranzicion, në vendet të cilat ballafaqohen me probleme më të mëdha. Nga ana tjetër, konceptet , konstruktet dhe teoritë të cilat janë të bazuara dhe të dëshmuara në botën perëndimore, nuk japid rezultate, përkatësisht nuk janë të zbatueshme në kontekstin tonë dhe në territorin tonë dhe mendoj se ai është problemi kyç me të cilin ballafaqohemi ne, mungesë të dhënat, mungesë e literaturës shkencore të vendit, e cila do të na jetë bazë nisëse për përgjigjen e disa pyetjeve të cilat i parashtrojmë ne. Ky është fakt pozitiv për Maqedoninë, sepse asnjë trend botëror nuk funksionon te ne dhe kjo mua edhe më tepër më bën skeptike. Ndoshta ne jemi në rrugë të vërtetë , megjithatë rruga

është e gjatë sepse deri më tash nuk kemi punuar asgjë, ndërsa ja tani edhe Ballkan monitori i fundit e konfirmon mendimin tonë nga projektet hulumtuese modeste të cilat i kemi realizuar, se ne kemi të vërteta të reja, realitet të ri në Maqedoni dhe se ajo që mendojmë se mund ta shfrytëzojmë nga literatura shkencore botërore nuk funksionon, nuk ka të bëjë me ne, thjesht ne jemi në qorrssokak sepse mungojnë hulumtime, bëhen presione për tu publikuar, bëhet presion që të zhvillohen hulumtime, megjithatë, mungon çdo lloj mbështetjeje, edhe administrative dhe financiare edhe në forcimin e kapaciteteve të brendshme të shkencëtarëve tanë. Ndonëse është trend botëror të rritet numri i hulumtuesve, ndonëse është trend në shkencat shoqërore të ketë dyqind mijë hulumtues, në Maqedoni është trend të zvogëlohet numri i hulumtuesve prej 3275 në vitin 1998 të biem në 2589 në vitin 2003. Trendi gjithkund është negativ. Edhe në sektorin e biznesit i cili punëson gjashtë herë më pak hulumtues, për dallim nga më parë, deri në arsimin e lartë dhe në sektorin publik. Hulumtimet janë zvogëluar gjithkund ndonëse trendi global është i kundërt. Mjetet janë konstantë, 0,2% nga BPV, ndërsa e dimë se

ajo nuk u dedikohet hulumtimeve por u dedikohet edhe shpenzimeve administrative në ato institucione hulumtuese publike. Pra, nevojat nuk përkijnë me atë që i investon shteti, nga ana tjetër, ai sot imponon disa standarde të reja. Sikur të mundemi, brenda natës, tu bashkohemi artificialisht atyre trendëve evropianë. Ndonëse mendoj se këto procedura administrative ekzistojnë edhe në Evropë.

*Kam përshtypjen se
dëshira për shkencë,
dëshira për dituri u humb
në këtë proces prej njëzet
vitesh*

*Nuk ekziston një lidhje sis-
tematike dhe kjo pengon
formimin e sinergjive në
hulumtimet, të cilat janë të
domosdoshme sepse qasja
multidisiplinare është e do-
mosdoshme në këtë shoqëri*

guar në ato baza të dhënash të zhurnalëve të njojur botërorë. U bë një lloj përpjekjeje, ajo u mundësua me mjete të huaja, por e njëjtë nuk shfrytëzohet sepse hulumtuesit e rinj nuk dinë si t'i përdorin ato baza të dhënash. Arsimi, arsimi i lartë neve nuk na përgatit për punë shkencore hulumtuese. Ne nuk

Kam përshtypjen se dëshira për shkencë, dëshira për dituri u humb në këtë proces prej njëzet vitesh. Sipas meje, këto janë arsyet për një situatë të tillë në shkencat shoqërore: mungesa e të dhënavë, jo vetëm hulumtime vendore, mospasje qasje në literaturën botërore etj. Dhe këtu kemi dy anë të medaljes. Nga njëra anë ne, tradicionalisht, si shtet, nuk kemi qenë të parapaguar në ato baza të dhënash të zhurnalëve të njojur botërorë. U bë një lloj përpjekjeje, ajo u mundësua me mjete të huaja, por e njëjtë nuk shfrytëzohet sepse hulumtuesit e rinj nuk dinë si t'i përdorin ato baza të dhënash. Arsimi, arsimi i lartë neve nuk na përgatit për punë shkencore hulumtuese. Ne nuk

**GJENDJA E HULUMTIMEVE NË SHKENCAT
SHOQËRORE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË**

mund të presim që studentët, hulumtuesit e rindë, të mësojnë vetë. Pra, në këtë kontekst, programe si RPPP janë shumë të mirëseardhur, megjithatë, pasi që edhe RRPP dhe të gjitha ata projekte rajonale përmblajnë në vete mundësi përfshirë forcimin e kapaciteteve përmes seminareve të cilat u ofrohen anëtarëve në rrjetin, nuk minden seminaret dyditore dhe treditore të kompensojnë diçka që zgjat disa kurse në universitetet evropiane. Nga ana tjetër, nuk jemi të lidhur, as ne si bashkësi tink-tenk ose si sektor joqeveritar në mes vetes, as bashkësia akademike, ndonëse ekzistojnë lidhje individuale. Megjithatë, kjo është një bashkësi e vogël, vend i vogël në të cilin të gjithë njihemi në mes vetes. Por, nuk ekziston një lidhje sistematike dhe kjo pengon formimin e sinergjive në hulumtimet, të cilat janë të domosdoshme sepse qasja multidisiplinare është e domosdoshme në këtë shoqëri sepse ne ballafaqohemi me kontekst tejet dinamik i cili kërkon, me të vërtetë, qasje gjithëpërfshirëse.

**DITURIJE ISMAILI
(UDHËHEQESE E ZYRËS SË HULUMTIMEVE PRANË
UNIVERSITETIT TË EVROPËS JUGLINDORE)**

Që nga themelimi i Universitetit të Evropës Juglindore, misionit i tij themelor ka qenë përfshirë krijuar dhe përfshirë dhënë akses në dituri të nivelit më të lartë, si dhe përfshirë mundësuar rritje intelektuale atyre që kërkojnë përfshirë zgjeruar njohurit ekzistuese, dhe të gjenerojë njohuri të reja. UEJL-ja që në fillim është përcaktuar krejtësisht përfshirë angazhim dhe reciprocitet të mësimit të kualitetit të lartë dhe hulumtimit në disiplina të ndryshme akademike në shkençat socio-ekonomike. Në dhjetor 2004, Bordi i Universitetit miratoi strategjinë e universitetit përfshirë kërkime shkencore, me përgjegjësi përfshirë zbatimin e planit të punës përfshirë hulumtimin në Universitet. Si pjesë e strategjisë përfshirë përmirësuar kërkimin shkencor, Universiteti ka rritur fondin përfshirë hulumtime dhe zhvillim të stafit, ndërsa mundësinë përfshirë zgjeruar fonde të jashtme përfshirë mbështetjen e projekteve kërkimore është një nga kriteret kryesore në caktimin e fondeve të Universitetit.

Universiteti gradualisht bën promovimin e programeve të hulumtimit në shkençat shoqërore dhe bursa lidhur me misionin e saj të arsimit në të gjitha tre cikle të përcaktuara me Procesit të Bolonjës, dhe kontribuon në zhvillimin ekonomik dhe social të Maqedonisë dhe të rajonit, megjithatë kjo nuk ka injoruar elementin e hulumtimit dhe bursave vetëm përfshirë akademike.

Diskutim

DUSHKO ALEKSOVSKI (UNIVERSITETI GOCE DELLÇEV, SHTIP)

Është tejet qenësor krahasimi i përvojës që e ka Universiteti Goce Dellçev në Shtip dhe i përvojës që e kisha si menaxher i një organizate joqeveritare. Aktivitetet hulumtuese shumë më thjesht, më shpejt, në mënyrë më efikase dhe më cilësore realizohen në sektorin joqeveritar, se sa në Universitet. Arsyja kryesore është se në sektorin joqeveritar burokracia është baras me zero, ndërsa në Universitet ne jemi të vrarë që nga hapi i parë për realizimin e projekteve, kur do të shohim se çfarë krejt pritet prej nesh. Nuk morëm asnjë denar për punë hulumtuese ndërsa realizuam 15 punime, nga të cilat, pesë në faktor impakt. Atëherë, cili është roli i shtetit, a është, vallë, stimulues ose jo stimulues? Nga ky forum duhet t'i drejtohemë drejtpërdrejtë shtetit se nuk mund të punohet në këtë mënyrë. Shteti duhet të organizohet dhe të jetë në funksion të hulumtimeve shkencore. Me politikë të këtillë nuk mund të përparojmë.

GJUNER ISMAIL (FORUMI TINK-TENK QHSD)

Politika tatile, mjaft e pa definuar e dekurajon sektorin e biznesit në Maqedoni që të jetë më dashamirës ndaj këtij lloji hulumtimesh. Duke pasur parasysh se interesit i biznesit në Maqedoni nënkupton artikulim të shpejtë të asaj që është investuar dhe kjo më së shpejti lëviz në terrenin e të ashtu-quajturit advertajzing, për terrenin e hulumtimeve as që ekziston vetëdije e as që mbeten do farë mjetesh. Biznesi aspak nuk ka ndërtuar vetëdijen për përgjegjësinë e tij sociale. Ky sektor, i cili nuk mundet ml të mbështetet në donacione nga jashtë e as që mundet të mbështetet në buxhetet e shtetit, mjaft të pakta, atëherë sektori i biznesit mbetet burim i tretë të cilit do të mundeshim, teorikisht, t'i drejtohemë. Si do ta artikulojmë atë dhe si do t'i drejtohemë sektorit të biznesit, kjo është diçka që ndodhet në rrugë dykahëshe dhe atje do të duhet të konstituohet si vetëdije, kurse nga ana jonë do të duhet të gjenden tema mjaft cilësore ose sfiduese dhe argumente mjaft të fuqishme gjatë shpjegimit, që të mundemi atë sektor biznesi, në ndonjë mënyrë, ta motivojmë që të jetë donator i projekteve në të cilat ai nuk është patjetër edhe të shihet, në të vërtetë, edhe nuk nënkuptoheq që duhet të shihet konkretisht.

GJENDJA E HULUMTIMEVE NË SHKENCAT SHOQËRORE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË

Problemi i dytë është ai më i përgjithshmi, e kjo do të thotë se shoqëria nuk ka nevojë të dijë për veten. Në të vërtetë, temë e jonë e përditshme është që t'i identifikojmë, t'i diagnostikojmë proceset dhe të sugjerojmë ndonjë rrugëdalje. Shtetin nuk guxojmë ta cilësojmë si të pa interesuar dhe ta shohim si artikuluese e ndonjë interes politik.

Elitat politike, në të vërtetë, më së paku duan ose nuk dinë për atë se ku, në të vërtetë, gjendemi ne dhe ku e çfarë definicionesh kanë në shoqërinë të cilën duan ta drejtojnë përmes mekanizmave shtetërore. Kjo nuk është ndonjë risi, kjo është tradicionale në këto zona dhe është karakteristike, si për sistemin e kaluar ashtu edhe për atë të tashmin dhe mendoj se neve patjetër, na takon të bëjmë një artikulim politik të nevojave tona dhe tu drejtohemë elitave politike të cilët, sot ose nesër, do të drejtojnë fondet e shtetit.

SLLAVICA INXHEVSKA (FISHHM, KOORDINATORE E PROGRAMIT NË HULUMTIMET E SHKENCAVE SHOQËRORE)

Tre vjet jam në këtë program, ashtu që marr informata dhe ndjek se çka ndodh në këtë sferë. Më duket interesante të shoh se si u përgjigjen detyrave të projekteve sistemet më të mëdha, sistemet më të vjetra si UKIM, UJI si partneritete publike private ose tink-tenket, përkatësisht sektori joqeveritar dhe mund të pajtohem me shumë konstatime, me disa jo. Dua ta pyes Ditrien, sepse një kohë të gjatë gjendet në Universitetin e Evropës juglindore, cilat janë sfidat me të cilat ballafaqoheni në dy-tre vitet e fundit dhe ,vallë , a gjeni mënyrë që të përgjigjeni në mënyrë sistemore, a ndryshuat diçka në atë strukturë, si reaguat në ata leksione të mësuara? Në UKIM u vendos kategoria –universitet dhe sistem i integruar. Tani shohim, pasi që u ngulfatën duke mos mundur të respondojnë me atë që ishin procese dhe sfida, iu kthyen rish-tazi ndonjë mini vendimi. Si reagoni ju në UEJL dhe tani, nëse duhet të nisni nga fillimi, vallë a do ta kishit të njëjtin sistem ose do të ndryshonit diçka?

DITURIJE ISMAILI

Zyra jonë është teknike administrative , në një farë mënyre ombrellë e këtyre aktiviteteve dhe fondeve edhe për projektet tona dhe për vetë Universitetin. Përveç kësaj ne u përpoqëm të absorbojmë fonde nga Komisioni Evropian nga FP7, që është shumë vështirë , u përpoqëm të fitojmë projekte edhe nga Ministria, ja tani aplikuam me dy projekte, por na thanë se këta fonde janë për universitetet shtetërore kështu që njëra prej atyre risive është

që ne mendojmë se pas nëntë vitesh kemi strukturë të re menaxhimi dhe rektor të ri. U orvatëm të bëjmë strategji të re dhe vlerësuam se na duhet koordinator i ri për FP7 dhe ajo koordinatore është zonja Tatjana Arsova dhe në çdo dy javë mban trajnime me kuadrin tonë, veçanërisht me hulumtues të rinx, për aplikimet në FP7, kështu që përpinqemi të arrijmë sukses në mënyra të ndryshme.

NENAD MARKOVIQ

Pritja të dëgjoj, ndoshta pak më tepër, për atë relacion ligjërime/hulertime. Mendoj se perceptimi që ekziston për profesorët është se funksioni i tyre primar është që të ligjerojnë, që është e saktë, ndonëse edhe unë mendoj se ekuilibri i mirë ndërmjet ligjërimeve dhe hulertimeve gjithherë jep rezultate të mira. Madhësia e grupeve në universitete (e cila mund të arrijë 120 njerëz bizarre), numri i orëve minimalë të mbajtura dhe ajo që do të kërkohet nga viti 2014, që do të hyjë në fuqi, po qe se nuk shohim ndonjë procedurë para Gjykatës Kushtetuese, si kritere do të jenë faktorë krejtësisht opstruktivë që të punohet çfarëdo hulumtimi. Dhe, nuk e di pse edhe është si kriter që duhet të publikoni në gazetë e cila ka redaktorë prej, të paktën, pesë shtete, që në shkencat politike është shumë vështirë, sepse më shpesh redaktorët janë nga Amerika. Me këtë tendencë do të ngulfatet pjesa hulumtuese.

NEDA KORUNOVSKA

Pasi për nga vokacioni jam juriste, mendoj se pak është e ditur se njëra prej të drejtave të përcaktuara me Deklaratën universale për të drejtat e njeriut është e drejta që të merret pjesë dhe të përhapen rezultatet e hulumtimit në interes të zhvillimit hulumtues dhe shkencor. Mendoj se ne edhe këtu kemi probleme, sepse edhe atë pak që e kemi nuk është sistematizuar.

**GJENDJA E HULUMTIMEVE NË SHKENCAT
SHOQËRORE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË**

**SESIONI I DYTË: FINANCIMI DHE LLOJE TË TJERA TË PËRKRAHJES SË
HULUMTIMEVE NË SHKENCAT SHOQËRORE NË
MAQEDONI. CILI ëSHTË ROLI I POLITIKËS?**

EMILIA SIMOSKA
**(PROFESORESHË NË INSTITUTIN PËR HULUMTIME
SOCIOLOGJIKE DHE POLITIKO-JURIDIKE, SHKUP)**

E dimë se një nga ata indikator sipas së cilave vet shoqëritë klasifikohen si të zhvilluara ose të pazhvilluara, është edhe përqindja që ndahet pér shkençën. Faktikisht, shkenca konsiderohen si një lloj, nëse jo luksoz, atëherë si diçka që vjen dhe duhet të bëhet pasi që të rehatohen të gjitha punët tjera. Nëse e vendojmë Maqedoninë në një shkallë të tillë ku i shikojmë këto indikatorë dhe përqindjet që ndahen pér shkençën, ajo padashim është në një nivel shumë të ulët në këtë rang listë, e nëse nga ai buxhet modest i ndajmë hulumtimet shoqërore atëherë do të biem dhe më poshtë.

Prandaj arrijmë në situatë që atë që e bëjnë institucionet shkencore më së shumti e shfrytëzojnë organizatat e huaja, e jo shteti që me vite të tëra ka investuar në këtë. Ky është një lloj inversioni. Mua më vjen keq që biseduesit më të ri e kanë përshtypjen se në Maqedoni nuk ka mjaftë hulumtime, se nuk punohet mjaftë ose se pjesë e atyre hulumtimeve nuk publikohen mjaftë. Më vjen keq që biseduesja e kaluar Korunovska ka një përshtypje të tillë, por në Maqedoni ka një fond fantastik nga hulumtimet në sferën e shkencave shoqërore. Ajo që paraqet problem është se nuk ekziston koordinim dhe vend ku do të mund të mësoni se si të hyni në qasje. Ajo që po ashtu më vjen keq është përshtypja e kolegëve më të ri pér mungesën e trajnimeve, se nuk kanë ku të profesionalizohen pér veprimtarinë shkencore hulumtuese. Trajnim pér punë shkencore hulumtuese nuk ekziston.

Arrijmë në situatë që atë që e bëjnë institucionet shkencore më së shumti e shfrytëzojnë organizatat e huaja, e jo shteti që me vite të tëra ka investuar në këtë

Problemi qëndron në atë se a ekziston kureshtje intelektuale, e cila nëse stimulohet pa dyshim do të shpin subjektin në shkencë edhe pa shkuar në kurs dhe pa i shpjeguar dikush se a bëhet ashtu në mënyrë metodologjike kështu ose ashtu

Ajnshtajni nuk ka pasur trajnim nga lëmi e hulumtimeve, ai ka krijuar shkencë. Hegelli dhe Kanti dhe të gjithë sociologët dhe filozofët prej të cilëve kemi mësuar nuk kanë pasur trajnim për shkencë, nuk kanë pas as internet, e kanë përdorur atë që e kanë pas pran dorës, ashtu kanë krijuar sisteme pa të cilat as ne sot nuk mund ti bëjmë hulumtimet tona. Nuk është problemi në këtë.

Nuk qëndron problemi këtu. Nuk është problemi as në përqindjen e praktikës hulumtuese të cilat janë nëpër fakultetet ose jo. Problemi qëndron në atë se a ekziston kureshtje intelektuale, e cila nëse stimulohet pa dyshim do të shpin subjektin në shkencë edhe pa shkuar në kurs dhe pa i shpjeguar dikush se a bëhet ashtu në mënyrë metodologjike kështu ose ashtu. Vët metodologjia është zanat, por pa kureshtjen intelektuale, (unë pajtohem se në shoqërinë tonë sistemi nuk është shumë stimulativ), ne nuk mund të kemi as çfarë rezultate. Unë do ti kisha cekur disa pika për të cilat mendoj se do të duhej të diskutonim në kuadër të këtij sesioni. E para, në rregullativën e cila qartë do ta definon edhe veprimtarin hulumtuese edhe rregullat sipas së cilës ajo realizohet deri në zgjedhje operative dhe e cila do ti vërteton jo vetëm obligimet e institucioneve të cilat e rregullojnë këtë veprimtar, por edhe ato të shtetit ndaj institucioneve. Nuk mendoj vetëm në obligimin për të nda rrogat, por edhe obligimin që rregullisht të realizohen projekte hulumtuese. E dyta, pa dyshim se ne kemi nevojë për ndonjë program qeveritar për prioritetë përfinancimin e hulumtimit shkencor. Që do të thotë se ai që i jep paret të propozon edhe tema, e ato që aplikojnë të ofrojnë në treg atë që kanë për të ofruar në lidhje me atë temë. Tregu të jetë në tema, e jo të aplikohet përmjete në cilën do temë të cilit secili prej neve do ti bie ndërmend dhe i duket si atraktive. Te ne situata është krejtësisht e kundërt. Dhe kuptohet, atë që e përmenda si pikë të tretë, është ekzistimi i ndonjë trupi profesional ose ekspert i cili do të mund të na jep ndonjë garanci në lidhje me realizimin e këtyre kritereve, vlerësimin, dhe vet vlerësuesit në lidhje me hulumtimet që bëhen në kuadër të shkencave shoqërore.

**VIOLETA ATANASOVSKA
(KOORDINATORE PËR FP7 NË MINISTRINË PËR ARSIM)**

Maqedonia u kyç në këtë program evropian të cilin unë e koordinoj në vitin 2005 dhe ishte në kuadër të FP6. Po ashtu patëm aktivitete edhe në FP5, mirëpo në FP6 (periudha prej vitit 2003-2007) ne kishim përkrahje më të madhe nga Qeveria, ministrët dhe funksionarët që ishin në Ministri. Me përkrahjen e tyre u bë ekspansion i pjesëmarries sonë në FP6, ishim lider në regjion dhe morëm rreth 6.5 milion euro vetëm për dy vite. Nëse merret

**GJENDJA E HULUMTIMEVE NË SHKENCAT
SHOQËRORE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË**

parasysh buxheti i shtetit për këtë sektor, i cili nuk ishte as dy milion euro, kjo ishte një sukses shumë i madh. Suksesi vazhdon edhe tani, por për fat të keq nuk kemi përkrahje dhe interes të mjaftueshmë, motivim dhe mjete për motivim të hulumtueseve për pjesëmarrje më të madhe. Ministria duhet ta bën këtë, mirëpo pare për shkencë nuk ka dhe ne jemi ndër shtetet e radha e cila nuk ndan pare që të bën stimulimin për të marr pjesë në këtë program, por edhe përskaj gjithave hulumtuesit tregojnë interes, së paku ata që kanë filluar të punojnë me programin, ashtu që kemi rezultate të mira dhe ky është një nga programet e radha që rregullisht lavdërohet në raportet e Komisionit Evropian për përparimin.

Në lidhje me pjesëmarrjen e shtetit këtu gjithmonë ka vërejtje se duhet ta zmadhojmë përqindjen, se duhet ti forcojmë kapacitetet administrative, se duhet ta rrisim nivelin në së paku një zyrë. Nuk ekziston vend evropian ku së paku njëzet veta nuk punojnë në këtë FP7 program. Te ne në Ministri jemi vetëm dy kolegë që punojmë në këtë program me orar të plotë pune edhe një që vjen si plotësim kur ka nevojë. Mirë është që kemi formuar një rrjet të personave që i kemi kontakt nacional nëpër sfera të ndryshme. Ata me shpesh janë prej fakulteteve, ata janë një tim i shkëlqyeshëm i njerëzve që maksimalisht janë dedikuar dhe mundohen në këtë punë, prandaj edhe rezultatet i kemi të mira. Për fat të keq në sferën e shkencave shoqërore humanitare nuk kemi person për kontakt nacional. Buxheti është më tepër se 50 miliard euro. Sferat tematike që i mbulon FP7 janë shkencat shoqëroro-ekonomike dhe shkencat humanitare që për Evropën kanë domethënienë të madhe dhe për çka ndahan më shumë se 600 milion euro – ndërsa për shkencat shoqërore rrëth një miliard euro. Këshilla ime për të gjithë ata që dëshirojnë të kyçen në FP7, është së pari ti përtërinë ose ti forcojnë kontaktet e tyre me partnerët e huaj të cilët punojnë në hulumtime, që janë të interesit të përbashkët, sepse në shkencat shoqëroro humanitare interes pothuaj se është i njëjtë.

**DANE TALESKI
(DOKTORANT NË UNIVERSITETIN QENDROR EVROPIAN NË BUDIMPEŞHTË)**

Në një situatë ideale, sipas teorisë dhe praktikave më të mira, secila politikë publike duhet të bazohet mbi analizën e situatës së përhershme që i merr parasysh nevojat, i definon problemet, udhëzon kah resurset e kapshme, i tregon alternativat e mundshme dhe rekomandon zgjedhje të realizueshme. Do të kisha dashur që ta ngrëjë vëmendjen tuaj te anketat hulumtuese sepse mendoj se ata janë të rendësishëm për kontekstin tonë. Në një situatë ideale ata i shërbejnë politikës që të jetë e informuar për qëndrimet e publikut, të dinë se ku është e hapur, ndërsa në cilat sfera duhet të jetë më

transparente. Dobia më e madhe nga hulumtimet anketuese është se ato ofrojnë më shumë informacione për perceptimin e politikës publike, kjo është baza kryesore për rekomandimet e ardhshme se si të ndërrohet, adaptohet dhe implementohet situata e zgjidhjeve politike dhe si të menaxhohen marrëdhëniet me publikun. Në një situatë ideale politika dhe hulumtuesit shkencor kanë një bashkëpunim të ngushtë.

Politika nga një anë është shfrytëzues she porositës i hulumtimeve shkencore, e nga ana tjeter është lëndë e po të njëjtave hulumtime. Megjithatë, duhet ta ngremë kufirin në këtë bashkëpunim. Gjithmonë duhet të kemi parasysh se hulumtimet mund vetëm të ndihmojnë në procesin e krijimit të politikave, por realisht ata nuk janë faktori i vetëm në procesin e marrjes së vendimeve. Hulumtimet tregojnë se çka është e mundshme të bëhet, mirëpo politika vendos se çka do të bëhet. E çfarë ndodh në Maqedoni? Ekzistojnë gjurmime tendencioze dhe manipulative, një pjesë e madhe janë pseudoshkencore dhe vetëm duken se janë shkencore, shumë shpesh manipulohet me pyetjet që parashtrohen dhe po ashtu manipulohet me temat në të cilën bëhet hulumtimi. Nga ana tjeter politika fuqishëm manipulan me prezantimin e informatave, bile edhe ato që janë shkencore prezantohen pjesërisht, ose shpjegimi i tyre shpesh herë janë politikisht të ngjyrosur. Kam përshtypje se kur flasim për interakcionin mes politikës dhe hulumtimeve shkencore, kur përmenden hulumtimet shkencore, më së shumti mendohet në anketat. Ata më së shumti lidhen me politikën dhe ata janë mjet i rregullt politik në komunikim e përditshëm dhe politik, por edhe manipulim politik. Te ne rezultatet e anketave shërbejnë si nxjerrje nga situata dhe një lloj arsyetimi ose legjitimitet i vendimeve politike, por pasi që janë marr vendimet, e siç është ideale, ta informojnë politikën që vendimet të janë më të mira. Ata përdoren për mobilizimin e mendimit publik, për konfirmimin si dhe për forcimin e disa pikëpamjeve. Realiteti te ne tregon se hulumtimet shkencore janë të nënvlérësuara dhe në masë më të madhe të keqpërdorura nga ana e politikës. Por, jo edhe aq faj të vogël kanë edhe vet hulumtuesit, para së gjithash ata nga shkencat shoqërore. Nga shkaqe të ndryshme e komprometojnë integritetin personal dhe objektivitetin e hulumtimeve. Mund të kenë ndonjë dobi nga ajo, por ajo është afatshkurtër dhe më shpesh materiale. Ka nevojë për komunikim neutral mes hulumtueseve dhe politikanëve. Është e nevojshme të kthehet integriteti i hulumtuesve dhe të ketë përzierje më të vogla në procesin e hulumtimit dhe për këtë mendoj se duhet të rekomandohet vet-rregullim.

Realiteti te ne tregon se hulumtimet shkencore janë të nënvlérësuara dhe në masë më të madhe të keqpërdorura nga ana e politikës

mundshme të bëhet, mirëpo politika vendos se çka do të bëhet. E çfarë ndodh në Maqedoni? Ekzistojnë gjurmime tendencioze dhe manipulative, një pjesë e madhe janë pseudoshkencore dhe vetëm duken se janë shkencore, shumë shpesh manipulohet me pyetjet që parashtrohen dhe po ashtu manipulohet me temat në të cilën bëhet hulumtimi. Nga ana tjeter politika fuqishëm manipulan me prezantimin e informatave, bile edhe ato që janë shkencore prezantohen pjesërisht, ose shpjegimi i tyre shpesh herë janë politikisht të ngjyrosur. Kam përshtypje se kur flasim për interakcionin mes politikës dhe hulumtimeve shkencore, kur përmenden hulumtimet shkencore, më së shumti mendohet në anketat. Ata më së shumti lidhen me politikën dhe ata janë mjet i rregullt politik në komunikim e përditshëm dhe politik, por edhe manipulim politik. Te ne rezultatet e anketave shërbejnë si nxjerrje nga situata dhe një lloj arsyetimi ose legjitimitet i vendimeve politike, por pasi që janë marr vendimet, e siç është ideale, ta informojnë politikën që vendimet të janë më të mira. Ata përdoren për mobilizimin e mendimit publik, për konfirmimin si dhe për forcimin e disa pikëpamjeve. Realiteti te ne tregon se hulumtimet shkencore janë të nënvlérësuara dhe në masë më të madhe të keqpërdorura nga ana e politikës. Por, jo edhe aq faj të vogël kanë edhe vet hulumtuesit, para së gjithash ata nga shkencat shoqërore. Nga shkaqe të ndryshme e komprometojnë integritetin personal dhe objektivitetin e hulumtimeve. Mund të kenë ndonjë dobi nga ajo, por ajo është afatshkurtër dhe më shpesh materiale. Ka nevojë për komunikim neutral mes hulumtueseve dhe politikanëve. Është e nevojshme të kthehet integriteti i hulumtuesve dhe të ketë përzierje më të vogla në procesin e hulumtimit dhe për këtë mendoj se duhet të rekomandohet vet-rregullim.

**GJENDJA E HULUMTIMEVE NË SHKENCAT
SHOQËRORE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË**

Diskutim

GJYNER ISMAIL

Nëse ne themi për vetvete se jemi njerëz me integritet me atë ne nuk e kemi mbaru punën deri në fund, por duhet të themi se kush konkretisht po lejon që me rezultatet e hulumtimeve të tija të manipulon. Që do të thotë se integriteti nuk është diçka që ne ashtu fshehurazi do ta rruam në vete dhe do ti tregojmë njëri tjetrit se ne kemi integritet. Jo, integritetin plotësisht do ta forcojmë dhe do ta potencojmë nëse tregojmë jo vetëm me gisht, por edhe me atë që është aleti jonë, çoftë ajo letër, deklaratë, se rezultatet e këtij dhe këtij instituti pikësëpari janë metodologjikisht të gabuar e plus manipulohet me ata.

**TEMELKO RISTESKI
(PROFESOR I DREJTËS ADMINISTRATIVE NË UNIVERSITETIN FON)**

Për shkak të mungesës së mjeteve financiare hulumtimet në fakultetin tonë përbëhen nga analiza e rregulloreve juridike, analizave krahasuese të rregulloreve normative të vendit dhe të rregullativës aktuale, pozitivo juridike dhe rregullativës historiko juridike. I përdorim informatat nga mjetet për informim publik, të cilat jo çdo herë janë të sigurt. Si dhe përdorim informata nga Enti shtetëror statistikor. Me shumë mundime mund të realizojmë ndonjë intervistë me udhëheqës administrator shtetëror që të arrijmë deri te disa të dhëna që na interesojnë. Për hulumtime anketore nuk mund të bëhet fjalë sepse nuk ka mjete. Nuk ka mjete as për punë individuale hulumtuese, edhe pse me mjetet tona modeste nga rrogat tona bëjmë diçka. Problem janë mjetet për prezantimin e asaj që e kemi hulumtuar, asaj që e kemi bë dhe shkruar. Nuk kemi mjete që të marrim pjesë në takime shkencore, veçanërisht në takime shkencore në vendet e huaja të cilat shumë çmohen. Institucionet private të arsimit të lartë, për dallim nga ato shtetërore, janë diçka më shumë biznes të orientuara dhe janë të kthyera kah procesi arsimor që sjell para. Për veprimtarinë shkencore hulumtuese ndajnë shumë pak mjete edhe atë që e ndajnë më shpesh përdoren për financimin e librave ose fjalorëve nga puna jonë shkencore hulumtuese në kuadër të procesit arsimor. Shteti neve nuk na përkrah në punën tonë shkencore hulumtuese edhe pse edhe këto hulumtime janë prej interesit publik. Sa i takon problemeve organizative, organet në institucionet e arsimit të lartë ndaj procesit arsimor kanë një marrëdhënie të tillë që ne jemi tepër të ngarkuar me punë administrative dhe nuk kemi kohë për punë shkencore. Kolegët ankohen se bile nuk kanë kohë diçka të lexojnë, e jo të merren me punë hulumtuese shkencore.

CANE MOJANOVSKI

(PROFESOR NË FAKULTETIN E SIGURIMIT PRAN UNIVERSITETIT NË MANANSTIR)

Sot secila mbledhje e të dhënave dhe secila formë e paraqitjes statistikore e të dhënave therritet hulumtimi. Ndoshta do të ishte mirë ta hapim pyetjen për formimin e komitetit shtetëror i cili do të diskuton dhe do të hap pyetje se a mund ti pyesim gjithçka qytetarët. Ka disa standarde metodologjike të cilat duhet të plotësohen. Në Kroaci dhe në disa vende tjera ekzistojnë komitet i cili do të diskuton për atë a keqpërdoren rezultatet nga hulumtimet dhe vallë secili që ka firmë për hulumtime shkencore me të vërtet do të mund të hapë pyetje të caktuara.

EMILIA SIMOSKA

Rreth kritereve dhe standardeve se çka gjithë mund ta pyesim qytetarin ka rregulla dhe ka hulumtime që janë anonime ose nuk janë anonime. Problemi qëndron diku tjetër. Paraqiten kvazi institucionale shkencore të cilat veten e quajnë Think Tank, të cilët aspak nuk i realizojnë hulumtimet, por vetëm shpallin të dhëna ose rezultate për diçka. Ne kemi dukuri të vizatimit të tabelave, e jo të numërimit të të dhënave.

DANE TALESKI

Ka shumë institucionale që i përkasin edhe shkencës edhe arsimin. Problem i madh te ne është dhënia e diplomave studentëve, magistraturave dhe doktoraturave. Jemi dëshmitar se si po kalohen studimet e magistraturës dhe doktoraturës, se sa të ne plagjiati është bë praksë shtëpiake. Unë pajtohem se ndoshta duhet të ketë një trup interuniversitar, i cili do të vendos standarde për kualitet. Për këtë shkak kjo bashkësi akademike ose hulumtuese e cila është mbledhur duhet me fuqishëm të lufton për drejtat e veta, sepse nëse të gjitha zgjedhjet priten nga politika dhe nga Qeveria, do të vinë shumë ngadalë ose fare nuk do të vinë. Nëse ne nuk bëjmë shtypje për të ndryshuar agjendën politike se kur bëhet buxheti duhet të ndahen mjete edhe për hulumtime shkencore, atëherë nuk do të ketë ndryshime. Shkenca duhet të lufton për drejtat e veta.

THE STATE OF RESEARCH IN SOCIAL SCIENCES IN THE REPUBLIC OF MACEDONIA

**Transcript From the Conference “The State of Research in Social Sciences in the Republic of Macedonia”,
14.04.2011, Hotel Continental,
Skopje, organized by Forum – Center for Strategic Research and Documentation, Skopje and think tank Analytica, Skopje, under the auspices of Regional Research Promotion Programme Western Balkans**

FIRST SESSION: SOCIAL SCIENCES AND THE RESEARCH IN MACEDONIA - WHERE ARE WE AND WHERE DO WE WANT TO BE?

NENAD MARKOVIK

(DOCENT OF POLITICAL STUDIES AT THE FACULTY OF LAW IN SKOPJE)

The state of social sciences is mostly determined by two large actors or two large spheres. One of them is the non-governmental sector and the think-tanks and the other are the universities. From my long past experience in the non-governmental sector, as well as at the university, I can make a comparative analysis in order to address the issue of where we are and where we want to be regarding social sciences. I think that 99% of the outcome in social sciences in the country is produced either at the universities or within the think-tanks, and a small part of the outcome is produced in the non-governmental sector. In the process of preparing the presentation, I faced the problem of not being able to make an accurate review of the state in social sciences, except regarding the organization I come from, the University Ss. Cyril and Methodius. The Rectorate has made a sufficient effort to store data about the number of projects in the process of implementation and about the type of projects being implemented.

In my opinion, universities are perceived by the general public as passive and closed bastions, and people see them as organizations that initiate little research and a few outputs. But the painful part is the lack of capacity use. However, I may say that large databases universities have are an advantage.

